

GJYKATA E QARKUT MITROVICË

P. Nr. 13/10

31 maj 2011

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E QARKUT MITROVICË, në Trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarët e EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati si Kryetare, dhe Klaus Jung dhe Nikolay Entchev si anë tarë, me pjesëmarrjen e Këshilltarit juridik të EULEX-it Kabil Merovci si procesmbajtës, në lëndën penale kundër;

Zaim Hajra, i akuzuar për vrasje, nga neni 146 të Kodit penal të Kosovës (KPK) dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, Paragrafi (2) të KPK, sipas Aktakuzës të Prokurorit publik të qarkut PP nr. 385/09, të datës 22 shkurt 2010, të parashtruar në gjykatë me datën 23 shkurt 2010, dhe të ndryshuar nga prokurori i EULEX-it me datën 23 maj 2011 dhe të parashtruar në gjykatë me 30 maj 2011;

Muhamet Hajra, , i akuzuar për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, Paragrafi (2) të KPK, sipas Aktakuzës të Prokurorit publik të qarkut PP nr. 385/09, të datës 22 shkurt 2010, të parashtruar në gjykatë me datën 23 shkurt 2010, dhe të ndryshuar nga prokurori i EULEX-it me datën 23 maj 2011 dhe të parashtruar në gjykatë me 30 maj 2011

Pas mbajtjes së seancës publike në lidhje me pranueshëmërinë e marrëveshjes për pranimin e fajësisë të datës 24 maj 2011, me 30 maj 2011, në praninë e të akuzuarve Zaim Hajra dhe Muhamet Hajra, Avokatëve të tyre të mbrojtjes Shefqet Ibrahimimi dhe Mahmut Halimi, prokurorit të EULEX-it Petr Klement dhe palëve të dëmtuara Xhemajl Hajra, Bashkim Halili, Nuhi Hyseni, dhe Bastrije Hajra, pasi që është arritur marrëveshja për pranimin e fajësisë me datën 30 maj 2011 dhe pas mbajtjes së seancës publike në lidhje me caktimin e dënimit me 31 maj 2011, në praninë e të akuzuarve, Avokatëve të tyre të mbrojtjes, prokurorit të EULEX-it, palëve të dëmtuara Nuhi Hyseni dhe Bastrije Hajra, pas shqyrtimit dhe votimit të Trupit gjykues me 31 maj 2011, në bazë të nenit 308A Paragrafi (15) i Kodit të procedurës penale të Kosovës (KPPK) shpallë në praninë e të akuzuarve, Avokatëve të tyre të mbrojtjes, prokurorit të EULEX-it, palëve të dëmtuara të pranishme, këtë

AKTGJYKIM

I akuzuari **Zaim Hajra**, i biri i Xhemajl Hajra dhe Naile Terakaj, i lindur me 25 maj 1984, në fshatin Rakinicë, komuna e Skenderaj, Shqiptar i Kosovës, me banim në fshatin Rakinicë, i martuar, babë i dy fëmijëve, i gjendjes mesatare ekonomike, të kryer shkollën e mesme, me profesion automekanik, me të ardhura përafërsisht prej 200-300 Euros në muaj, nuk dihet të ketë pasë dënim të më parëm, në paraburgim prej datës 28 nëntor 2009,

Pasi që është deklaruar se është i fajshëm për veprat penale Vrasje, nga neni 146 të Kodit penal të Kosovës (KPK), dhe Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, Paragrafi (2) të KPK, në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë të datës 24 maj 2011 dhe pasi që gjykata e ka pranuar Marrëveshjen në bazë të pranimin të fajësisë me datën 30 maj 2011 dhe e ka regjistruar në gjykatë me 30 maj 2011

DËNOHET

- me 7 /shtatë/ vjet burgim për veprën penale të Vrasjes
- me 3 /tre/ vjet burgim për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve.

Dënimi unik caktohet të jetë **8 /tetë/ vite burgim**, në bazë të nenit 71 Paragrafi (1) dhe Paragrafi (2) Pika 2 e KPK.

Koha e kaluar në paraburgim nga data 28 nëntor 2009 do të llogaritet në bazë të nenit 73 Paragrafi (1) i KPK.

I akuzuari **Muhamet Hajra**, i biri i Ferat Hajra dhe Ganimete Nazifi, i lindur me 04 korrik 1983, në fshatin Rakinicë, komuna e Skenderaj, Shqiptar i Kosovës, me banim në fshatin Rakinicë, i martuar, babë i dy fëmijëve, i gjendjes mesatare ekonomike, të kryer shkollën e mesme, me profesion automekanik, me të ardhura personal për afërsisht prej 300 Euro në muaj, nuk dihet të ketë pasë dënim të më parëm, në paraburgim prej datës 28 nëntor 2009,

Pasi që është deklaruar se është i fajshëm për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, Paragrafi (1) të KPK, në bazë të marrëveshjes për pranimin e fajësisë të datës 24 maj 2011 dhe pasi që gjykata e ka pranuar Marrëveshjen në bazë të pranimin të fajësisë me datën 30 maj 2011 dhe e ka regjistruar në gjykatë me 30 maj 2011

DËNOHET

- me 3 /tre/ vjet burgim për verën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve.

Koha e kaluar në paraburgim nga data 28 nëntor 2009 do të llogaritet në bazë të nenit 73 Paragrafi (1) i KPK.

Pushka gjysmë automatike, "Type 56" numri serik 11279836 dhe të revoles "SIG" type P210, me numër serik A110873 konfiskohen në bazë të nenit 60 Paragrafi (1) dhe nenit 328 Paragrafi (5) o KPK.

ARSYETIMI

A. HISTORIKU I PROCEDURËS

Prokurori publik i qarkut në Mitrovicë, në aktakuzën PP. no. 385/09 të datës 22 shkurt 2010 i ka akuzuar të dy të akuzuarit me veprën penale vrasje e rëndë nga neni 147 pika 4 të Kodit penal të Kosovës (KPK), për dy vepra të vrasjes në tentativë nga neni 146 në lidhje me nenet 20 dhe 23 të KPK, dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, Paragrafi (2) të KPK.

Seanca kryesore është caktuar që të filloj me 24 maj 2011 dhe të vazhdoj me datat 30, 31 maj dhe 1 qershor 2011, por fillimi është shty për shkak të negociatave në mes të palëve në lidhje me marrëveshje për të pranuar fajësinë. Me 30 maj 2011, prokurori i EULEX-it e ka informuar gjykatën se marrëveshja për pranimin e fajësisë ishte arritur dhe ishte nënshkruar nga palët dhe nga Zëvendës Kryeprokurori i EULEX-it. Me 31 maj 2011, prokurori i EULEX-it ka parashtruar tërheqjen e pjesëshme dhe ndryshimin e aktakuzës, të datës 23 maj 2011, duke e akuzuar të akuzuarin Zaim Hajra për veprën penale vrasje nga neni 146 të KPK dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, Paragrafi (2), ndërsa të akuzuarin Muhamet Hajra, për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, Paragrafi (1). Të gjitha akuzat tjera nga Aktakuza e kaluar janë tërhequr nga prokurori.

B. KOMPETENCA E GJYKATËS

Sipas nenit 23, pika 1)-i) e KPPK, gjykatat e qarkut janë kompetente që të gjykojnë rastet për të cilat ligji parasheh që të jepet dënimi prej së paku pesë vitesh burgim. Në bazë të nenit 27 paragrafi (1) të KPPK kompetenca territoriale i takon gjykatës nga qarku në të cilin supozohet se është kryer vepra penale.

Sikurse që është përmendë më lartë, akuzat për vrasje nga neni 146 të KPK lejon caktimin e dënimit minimal prej 5 vitesh burgim. Po ashtu, aktakuza në këtë lëndë bën me dije se të akuzuarit i kanë kryer veprat në fshatin Rakinicë, komuna e Skenderajt.

Prandaj, Gjykata e qarkut e Mitrovicës është organ kompetent juridik për ta gjykuar këtë procedurë penale.

Me 09 shkurt 2011, Kryetari i Asamblesë së gjyqtarëve të EULEX-it ja ka caktuar lëndën gjyqtarëve të EULEX-it, në bazë të nenit 3.3 të Ligjit për kompetenca, zgjedhjen dhe caktimin e lëndëve gjyqtarëve të EULEX-it.

Prandaj, gjyqtarët e EULEX-it të caktuar në Gjykatën e qarkut të Mitrovicës janë kompetent që të gjykojnë këtë lëndë. Trupi gjykues është përpiluar në përbërje të gjyqtarëve të EULEX-it Hajnalka Veronika Karpati si Kryetare e trupit gjykues dhe Klaus Jung dhe Nikolay Entchev si anëtarë.

Asnjëra palë nuk ka pasë vërejtje në përbërjen e Trupit gjykues.

C. MARRËVESHJA PËR PRANIMIN E FAJËSISË

Marrëveshja për pranimin e fajësisë është prezantuar në Gjykatë në një seancës publike në lidhje me pranueshëmërinë e marrëveshjes për pranimin e fajësisë në bazë të nenit 308A Paragrafi (9) i KPPK me 30 maj 2011.

I akuzuari Zaim Hajra ka pranuar fajësinë për veprën penale vrasje nga neni 146 të Kodit penal të Kosovës KPK dhe për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, Paragrafi (2) të KPK, derisa i akuzuari Muhamet Hajra ka pranuar fajësinë për veprën penale Mbajtja në pronësi, kontroll, posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve nga neni 328, Paragrafi (1) të KPK.

Marrëveshja për pranimin e fajësisë ka përmbajtur këto konkluzione faktike:

“Me 28 nëntor 2009, për afërsisht rreth orës 3:30 në Rakinicë, Skenderaj, pasi që kanë marrë vesh se Shqipe Hajra- motra e të pandehurit Zaim Hajra, dhe Bastrije Hajra- motra e të pandehurit Muhamet Hajra, kanë dalë me të dashurit e tyre Bashkim Halili dhe Nuhi Hyseni, Zaim Hajra ka marrë pistoletën “SIG” me numër serik No. A110873 të kalibrit 9x19 mm. dhe Muhamet Hajra ka marrë pushkën e gjuetisë gjysmë automatike, “Tenner”, numri serik 112729836 të kalibrit 7.62x39 mm. Dhe një sëpatë. Mandej të pandehurit kanë shkuar në veturën e Zaim Hajrës Seat Toledo në rrugën e fshatit, e kanë parkuar përball rrugës ashtu që të ta bllokojnë atë dhe të fshihen afër.

Palët e dëmtuar kanë mbërritur në vendin në veturën e Bashkim Halilit “Shiroko”, me tabela nr. 339-KS-368, dhe janë ndaluar para pengesës. Të pandehurit kanë dalë nga vendet ku ishin të fshehur dhe janë paraqitur afër veturës së viktimës ku Zaim Hajra ka shkrepë me pistoletën e tij “SIG” në drejtim të Shqipe Hajra e cila ishte e ulur afër vozitësit Bashkim Halili. Plumbi e ka qëlluar pjesën e sipërme të hundës së Shqipe Hajrës, ka kaluar nëpërmes të zgavrës së kafkës dhe ka dalë nga pjesa e pasme e kokës duke shkaktuar dëmtime të trurit të cilat kanë shkaktuar vdekjen e viktimës. I njëjti plumb e ka gërvishur qafën e Bashkim Halilit. Muhamet Hajra i mbante në shënjestër nga pas të dëmtuarit duke e drejtuar pushkën e gjuetisë “Tenner” në drejtim të tyre, por pasi që është shkrepur plumbi, ai ka thanë “Oh Zaim, çka bane ashtu, e ke vra Shqipen, të vraftë Zoti”. Mandej të pandehurit e kanë rrahur Bashkim Halilin dhe Nuhi Hyseni me dorëza të armëve të tyre, e kanë nxjerrë trupin e Shqipe Hajrës nga vetura e kanë vendosur në veturën e tyre dhe e kanë dërguar në spital në Skenderaj. Të pandehurit pastaj janë kthyer dhe i kanë kërkuar Bashkim Halilin dhe Nuhi Hysenin, të cilin ishin strehuar në stacion të policisë në Skenderaj ku të pandehurit tentuan të hynin me forcë, por ata u penguan dhe më në fund u arrestuan nga policët e Policisë së Kosovës.

I akuzuari Zaim Hajra, që nga një datë e panjohur e deri më 28 Nëntor 2009, ka poseduar një revole “Sig”, tipi P210, me numër serik A110873, kalibër 9x19 mm, dhe shtatë fishek të kalibrit të njëjtë pa kurrfarë leje të vlefshme nga autoritetet kompetente.

Palët e dëmtuara Xhemajl Hajra, Bashkim Halili, Nuhi Hyseni dhe Bastrije Hajra kanë qenë prezent në seancën publike më 30 Maj 2011. Palët e dëmtuara kanë konfirmuar që ata ishin informuar nga prokurori për Marrëveshjen mbi Pranimin e Fajësisë.

Sipas Nenit 308A Paragrafi (5) të KPPK, Palës së Dëmtuar duhet të i jepet mundësia që të i prezantojë gjykatës një deklaratë në lidhje me kërkesën pasurore juridike. Në këtë rast, të gjitha palët e dëmtuara – pasi që atyre i janë dhënë udhëzimet relevante dhe pasi që atyre i është shpjeguar se çfarë është kërkesa pasurore juridike – kanë deklaruar që ata nuk do të parashtrorjnë një kërkesë të tillë. Atyre i është dhënë rasti që të prezantojnë komentet e tyre mbi marrëveshjen mbi pranimin e fajësisë dhe ata të gjithë kanë deklaruar që ata nuk kanë asgjë kundër marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë.

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është pranuar nga Gjykata në ditën e seancës sipas Nenit 308A Paragrafi (10) dhe (15) të KPPK me korrigjimet në vijim:

Në paragrafin e parë të versionit Shqip të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë sa i përket të pandehurit Zaim Hajra, kualifikimi i akuzës duhet të thotë – Neni 328 Paragrafi (2) i KPPK në vend të Neni 328 Paragrafi (1) i KPPK.

Pas marrjes në pyetje të të Akuzuarve, avokatëve të tyre mbrojtës dhe Prokurorit Publik, Gjykata ka gjetur që Marrëveshja mbi Pranimin e Fajësisë i plotëson kushtet sipas Nenit 308A Paragrafi (12); Të Akuzuarit kanë kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, ata vullnetarisht janë deklaruar të fajshëm pas konsultimeve të mjaftueshme me avokatët e tyre mbrojtës, ata nuk janë shtrënguar në asnjë mënyrë dhe nuk janë detyruar që të deklarohen të fajshëm. Për më tepër, pranimi i fajësisë mbështetet nga faktet dhe provat e lëndës, dëshmitë e dëshmitarëve, deklaratat e të Akuzuarve dhe provat nga dokumentet në dosje të lëndës. Prandaj, sipas 308A Paragrafi (15) të KPPK, Gjykata ka urdhëruar që Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë të parashtrohet në Gjykatë dhe e ka caktuar seancën mbi dënimin për 31 Maj 2011.

Marrëveshja mbi pranimin e fajësisë është parashtruar në Gjykatë në ditën e njëjtë, 30 Maj 2011.

D. DËNIMI

Më 31 Maj 2011 trupi gjykues i ka dëgjuar argumentet e të gjitha palëve në lidhje me dënimin. Palët kanë prezantuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese. Palët e dëmtuara Nuhi Hyseni dhe Bastrije Hajra kanë qenë prezent në këtë seancë. Pas shqyrtimit, trupi gjykues e ka shpallur dënimin sipas Nenit 308A Paragrafi (15) të KPPK.

Gjatë përcaktimit të sanksionit penal gjykata duhet të ketë parasysh edhe qëllimin e përgjithshëm të dënimit – i cili është që të shtyp aktivitetet e rrezikshme për shoqërinë

duke i parandaluar të tjerët nga kryerja e veprave të ngjashme penale dhe qëllimin specifik, që të parandalojë kryerësin nga kryerja e ndonjë vepre të re penale.

Në këtë rast trupi gjykues është i bindur që dënimi i shpallur me burgim do të arrijë qëllimin individual të dënimit. Megjithatë, nga pikëpamja e qëllimit të dytë të dënimit, aspektit social, dënimi i shpallur është qartazi i butë. Vrasja e motrës vetëm pse ajo ishte duke kaluar me dikë është një rast i rëndë i veprës penale dhe dënimi duhet të i dërgojë mesazh shoqërisë që trajtimi i tillë i grave nuk do të tolerohet dhe duhet të dënohet në përputhje me rrethanat. Gjykata duhet të theksojë që vetëm për shkak të marrëveshjes mbi pranimin e fajësisë dhe për shkak të faktit që rrethanat lehtësuese të këtij rasti specifik tejkalojnë rrethanat rënduese, ajo nuk e ka shpallur një dënim më të gjatë të burgimit për vrasjen. Trupi gjykues nuk ka mundur të konsiderojë si rrethanë lehtësuese që i akuzuari ka vepruar sipas kërkesave morale të traditave të shoqërisë vendore.

Sa i përket veprës penale të Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve në rastin e të dy të akuzuarve, gjykata cekë që ajo ka marrë parasysh, kur ka shpallur dënimin me 3 vjet burgim si dënim, që rreziku ndaj shoqërisë i kësaj vepre penale është veçanërisht i lartë. Siç tregojnë rastet tjera penale në rajon dhe në tërë Kosovën, ekziston një tendencë fatkeqe në këtë shoqëri që të zgjidhen problemet, ato brenda familjes apo në mes fqinjëve, me armë në të cilat ka qasje aq të lehtë.

Trupi gjykues ka konsideruar si rrethanë lehtësuese gjendjen familjare të të dy të akuzuarve, që ata janë mbajtësit e vetëm të familjeve të tyre, që ata nuk kanë dosje të mëparshme penale, që ata janë deklaruar të fajshëm për akuzat e ndryshuara të vrasjes dhe armëmbajtjes dhe përdorimit të armës pa leje dhe me peshë më të madhe pajtimi me palët e dëmtuara, gatishmëria e tyre që të ia falin.

Trupi gjykues ka konsideruar si rrethanë rënduese mënyrën në të cilën është kryer vepra penale, gjatë natës, duke i vënë pritë, dhe moshën e re të viktimës.

Në këtë rast për veprën penale të vrasjes sipas Nenit 146 të KPK, ligji parasheh dënimin minimal prej 5 viteve burgim. Për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas Nenit 328, Paragrafi (2), ligji parasheh dënimin me gjobë deri në 7.500 euro, ose dënim me një (1) deri në tetë (8) vjet, (akuza kundër Zaim Hajrës).

Për veprën penale Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas Nenit 328 Paragrafi (1), ligji parasheh dënimin me gjobë deri në 10.000 euro, ose me burgim prej një (1) deri në dhjetë (10) vjet, (akuza kundër Muhamet Hajrës).

Duke marrë parasysh të gjitha rrethanat lehtësuese dhe rënduese trupi gjykues e ka dënuar të akuzuarin Zaim Hajra me shtatë (7) vite burgim për veprën penale të vrasjes sipas Nenit 146 të KPK, dhe tri (3) vite burgim për veprën penale të Mbajtjes në pronësi,

në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas Nenit 328 Paragrafi (1).

Trupi gjykues e ka dënuar të akuzuarin Muhamet Hajra me tri (3) vjet burgim për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas Nenit 328 Paragrafi (1).

Zaim Hajra ka kryer dy vepra penale. Sipas rregullave të kalkulimit të dënimit të bashkuar, dënimi unik duhet të jetë më i lartë se secili prej dënimeve individuale, por jo aq i lartë sa shuma e dënimeve të caktuara. Trupi gjykues ka shpallur dënimin prej 8 viteve burgim si dënim unik sipas Nenit 71 Paragrafet (1) dhe (2) pika 2 e KPK.

Të dy të akuzuarit janë në paraburgim që nga 28 Nëntori 2009. Kjo periudhë kohore do të llogaritet në dënimin e shpallur sipas Nenit 73 Paragrafi (1) të KPK.

E. LIGJI I APLIKUESHËM

Veprat penale janë kryer më 28 Nëntor 2009. Në atë kohë ligj i aplikueshëm ka qenë Kodi Penal i Kosovës (KPK) i cili ka hy në fuqi më 06 Janar 2009. Sipas Nenit 2 Paragrafet (1) dhe (2) të KPK, ligji në fuqi në kohën e kryerjes së veprës penale do të aplikohet ndaj kryerësit përveç nëse një ligj i ri është më i favorshëm për të akuzuarin. I akuzuari është deklaruar i fajshëm për veprën penale sipas KPK.

F. KONFISKIMI

Pushka gjysmë automatike, “Tipi 56” numri serik 11279836 dhe revolja “SIG” tipi P210 me numër serik A110873 janë konfiskuar sipas Nenit 60 Paragrafi (1) dhe Nenit 328 Paragrafi (5) të KPK.

G. SHPENZIMET

I akuzuari Zaim Hajra është deklaruar i fajshëm për veprën penale të Vrasjes sipas Nenit 146 të KPK, dhe Mbajtje në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas Nenit 328 Paragrafi (2), përderisa i akuzuari Muhamet Hajra është deklaruar i fajshëm për veprën penale të Mbajtjes në pronësi, në kontroll, në posedim ose në shfrytëzim të paautorizuar të armëve sipas Nenit 328 Paragrafi (1). Prandaj ata duhet të i kompensojnë pjesët e tyre të shpenzimeve të procedurës penale sipas Nenit 102 Paragrafi (1) të KPPK me përjashtim të shpenzimeve të përkthimit. Një aktvendim i veçantë mbi shumën e shpenzimeve do të lëshohet nga gjykata kur shënimet e tilla sigurohen sipas Nenit 100 Paragrafi (2) të KPPK.

Procesmbajtës
Kabil Merovci

Kryetarja e Trupit Gjykues
Hajnalka Veronika Karpati

KËSHILLË JURIDIKE: Ky aktgjykim sa i përket dënimin ka marrë formë të prerë në ditën e shpalljes së tij pasi që ai nuk bie nën Nenin 308A Paragrafi (8) pika 1 e KPPK.